

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Seanca plenare

Nr. 02-42/03-07

Prishtinë, më 8 shkurt 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 78 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 26 janarit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Miratimi i tekstit përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë, nr. 2003/17,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për raportimin financiar të ndërmarrjeve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpronësimet me interes publik,
8. Shqyrtimi i propozimit të GP të AAK-së për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare,
9. Debat për tre qytetarë të Kosovës që akuzohen në Gjykatën e Hagës, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve të Kuvendit,
10. Shqyrtimi i mocionit të shtatë deputetëve për shpalljen e 27 prillit – Ditë e të pagjeturve në Kosovë dhe
11. Njoftimi për vendimin e Kryesisë së Kuvendit për rishpalljen e konkursit për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** kërkoi të procedohet sipas propozimit të rendit të ditës, ngase Kryesia e Kuvendit nuk ka marrë asnjë mocion për ndryshimin apo plotësimin e tij.

Deputeti **Xhevat Bislimi** (PDK) tha se në emër të banorëve të fshatit Debëllde dhe të qytetarëve të komunës së Vitisë, Kuvendi i Kosovës në seancën e sotme ta rikonfirmojë Rezolutën e miratuar më 23 maj të vitit 2002 për ruajtjen e tërësisë territoriale të Kosovës, përkatësisht për mosnjohjen e Marrëveshjes ndërmjet RFJ-së dhe IRJM-së të dt.21.01.2001 për caktimin e zonës kufitare ndërmjet IRJM-së dhe Kosovës.

**Kryetari** tha se kjo çështje mund të shtrohet në seancën e nesërme, ngase debatohet për propozimin e të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës.

**Kuvendi**, me shumicë votash, **miratoi rendin e ditës**, të propozuar nga Kryesia e Kuvendit.

### **2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 26 janarit 2007**

Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të 26 janarit 2007 pa vërejtje.

### **3. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrou pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, lidhur me zhbllokimin e privatizimit të ndërmarrjeve dhe të objekteve shoqërore në komunën e Shtërpçës dhe në komunat e tjera të banuara nga komuniteti serb.

Kryeministri Agim Çeku nuk ishte i pranishëm në seancë. Përgjigjja mbetet për seancën e radhës.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtrou pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me mostransparençën e aneks kontratave ndërmjet AKM-së dhe IMR-ALFERONIT.

Ministri **Bujar Dugolli** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i kishte parashtruar pyetje ministrit të Arsimit lidhur me kushtet e vështira në disa objekte të shkollave në komunën e Vitisë.

Ministri **Agim Veliu** i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit Bislimi. Deputeti Xhevat Bislimi tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen me shkrim, andaj kërkon përgjigje gojore nga ministri Veliu për seancën e radhës.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i kishte parashtruar pyetje ministrin të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Agim Veliu**, lidhur me njohjen e barabartë të diplomave të studimeve që kishin zgjatur katër vjet dhe të atyre që tani zgjasin tre vjet, sipas sistemit të Bolonjës.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Agim Veliu**, iu kishte përgjigjur me shkrim deputetit Ramadan Kelmendi.

#### **4. Miratimi i tekstit përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor**

Kryesuesi i seancës, **Xhavit Haliti**, e ftoi përfaqësuesin e Komisionit Funksional për ta arsyetuar propozimin e Komisionit.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Transport, **Ibush Jonuzi** tha se Komisioni, në bashkëpunim me administratën e Kuvendit, në bazë të vendimit të seancës së mëparshme, e ka përgatitur tekstin përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe i propozon Kuvendit ta miratojë.

Kryesuesi e hodhi në votim tekstin përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----73,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 2.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për sigurinë në komunikacion rrugor.

#### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin publik në Kosovë**

**Kryesuesi** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit Funksional ta paraqesë raportin e komisionit para deputetëve të Kuvendit.

**Naser Osmani**, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, i arsyetoi amendamentet e propozuara për këtë projektligj. Janë propozuar një numër amendamentesh, shtoi z. Osmani, në bazë të pengesave që ka hasur zbatimi i këtij ligji në praktikë, si dhe të kërkesave të agjencive për ta përmirësuar për ta bërë më lehtë të zbatueshëm këtë ligj.

Ndryshimet kryesore të këtij projektligji kanë të bëjnë me ndarjen e KRRPP-së në dy njësi: a) Komisioni i Rregullave për Prokurim Publik dhe b) Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, që deri tani kanë qenë në një organ të përbashkët. Në bazë të përvojës dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare të kësaj fushe këto dy organe duhet të jenë të veçanta. Ai i ftoi deputetët e Kuvendit t' i miratonin amendamentet e propozuara.

**Kryesuesi** i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurim publik në Kosovë.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99 dhe 100.

Pastaj kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----66;

Kundër----- 1.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për raportimin financiar të ndërmarrjeve**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projektligjin për raportimin financiar të ndërmarrjeve.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68;

Kundër----- 0.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Ligjin për raportimin financiar të ndërmarrjeve.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpronësimet me interes publik**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për Projektligjin për shpronësimet me interes publik.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48 dhe 49.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----70;  
Kundër----- 0.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Ligjin për shpronësimet me interes publik.

**Kryetari** dha pauzë për drekë.

### **8. Shqyrtimi i mocionit të Grupit Parlamentar të AAK-së për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare**

**Kryesuesi** i seancës e ftoi përfaqësuesin e parashtruesit të mocionit ta marrte fjalën.

**Gjynaze Syla** në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për nxjerrjen e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare.

Në vazhdim deputetja **Syla** paraqiti edhe testin e Projektrezolutës si vijon:

Kuvendi i Kosovës miraton këtë

### **REZOLUTË**

për organizimin e diasporës kosovare dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e Kosovës

1. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës ta hartojë ligjin për organizimin e diasporës në mënyrë institucionale;
2. Kuvendi i Kosovës, duke u bazuar në Ligjin për organizimin e diasporës, rekomandon krijimin e mekanizmave të diasporës, që do të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet e Kosovës në promovimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës;
3. Kuvendi i Kosovës nxit Qeverinë që të zhvillojë politika stimuluese, të favorshme për investimet e diasporës në Kosovë;
4. Kuvendi i Kosovës mbështet iniciativën për krijimin e këshillit konsultativ ekonomik të përbërë nga biznesmenët e shquar kosovarë në diasporë dhe miqtë e shquar të huaj;
5. Kuvendi i Kosovës fton Qeverinë e Kosovës, që në kuadër të projektit për regjistrimin e popullsisë të inkorporojë planin për regjistrimin e popullsisë së Kosovës jashtë vendit;
6. Kuvendi i Kosovës garanton me ligj të drejtën e qytetarëve tanë, që jetojnë jashtë vendit për të marrë pjesë në votimet në Kosovë;

7. Kuvendi i Kosovës garanton që në listat e zgjedhësve për Kuvendin e Kosovës të përfshihen edhe qytetarët nga diaspora;
8. Me propozim të Kuvendit të Kosovës, kryetari i Kosovës, një herë në vit, ndan çmimin për diasporën, për kontributin e dalluar në të mirë të Kosovës;
9. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria që t'ia lehtësojë diasporës rregullimin e çështjeve administrative dhe përmes internetit të sigurojë qasjen në informatat për shërbimet publike, për investimet e mundshme për vendet turistike, për kulturën dhe letërsinë e Kosovës.

Në fund deputetja Sylja i ftoi deputetët e Kuvendit ta mbështetnin rezolutën e cekur më lart.

**Kryesuesi** e hapi debatin për Projektrezolutën e paraqitur nga Grupi Parlamentar i AAK-së

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për Projektrezolutën e paraqitur nga Grupi Parlamentar i AAK-së, si dhe për rëndësinë dhe kontributin e dhënë të mërgatës sonë për rezistencën ndaj okupimit të vendit, për ndihmën ekonomike dhe për pjesëmarrjen e saj për çlirimin e vendit dhanë edhe këta deputetë: **Nekibe Kelmendi, Hydajet Hyseni, Teutë Sahatçiu, Xhezair Murati, Gjergj Dedaj, Emrush Xhemajli, Xhevat Bislimi, Berat Luzha, Nazim Jashari, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Alush Gashi dhe Jakup Krasniqi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit Kuvendi, me shumicë, votash nxori këtë

## P Ë R F U N D I M

1. Teksti i Projektrezolutës për organizimin e diasporës kosovare dhe për bashkëpunimin e saj me institucionet e Kosovës të harmonizohet ndërmjet grupeve parlamentare të Kuvendit.
2. Teksti i harmonizuar i Projektrezolutës t'i paraqitet Kuvendit në seancën e ardhshme për miratim.

### **9. Debat për tre qytetarë të Kosovës që akuzohen në Gjykatën e Hagës, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve të Kuvendit**

**Kryesuesi** e ftoi parashtruesin e mocionit ta marhte fjalën.

Deputeti **Nait Hasani** e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit mocionin e parashtruar për mbështetje institucionale për të akuzuarit nga Kosova në Gjykatën e Hagës: Lah Ibrahimaj, Idriz Balaj, Hajradin Balaj dhe ish- kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili është në mbrojtje në liri.

Në vazhdim, deputeti Hasani paraqiti tekstin e Projektdeklaratës si vijon:

Kuvendi i Kosovës,

Në mbrojtje të vlerave njerëzore dhe politike, të gjakut të dëshmorëve dhe të sakrificës sublime të popullit tonë, miraton këtë

## DEKLARATË

Për mbështetje institucionale të të akuzuarve nga Kosova në Gjykatën e Hagës

1. Asistencë ligjore dhe juridike stafit të avokatëve, përkthyes 1, ndihmës ligjor 3, hetues të mbrojtjes 2, shpenzimet e transportit në shumën mujore gjithsej 18.000€..
2. Një grup i deputetëve të Kuvendit dhe ministri i Drejtësisë t'i vizitojnë të akuzuarit shqiptarë në burgun e Shevingenit në Hagë.
3. Ndihmë mujore të akuzuarve nga 1000 euro për shpenzime ditore.
4. Një mbështetje në të holla në shumën prej 100.000€ për familjet e të akuzuarve në Gjykatën e Hagës, për të mos u bërë raste sociale dhe për të pasur mundësi t'i vizitojnë të afërmit e tyre në Hagë.

Në fund, deputeti Hasani i ftoi deputetët e Kuvendit ta mbështetin deklaratën e cekur më lart.

Kryesuesi e hapi debatin për të akuzuarit nga Kosova në Gjykatën e Hagës.

Opinione dhe sugjerime lidhur me Projektdeklaratën e paraqitur nga deputeti Hasani dhanë edhe këta deputetë: Alush Gashi, Gjylnaze Syla, Emrush Xhemajli, Nazim Jahari, Hajredin Hyseni dhe Berat Luzha, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, Kuvendi me shumicë votash nxori këtë

## PËRFUNDIM

1. Teksti i Projektdeklaratës për mbështetje institucionale të akuzuarve nga Kosova në Gjykatën e Hagës të harmonizohet ndërmjet grupeve parlamentare, të kërkohet mendimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, si dhe të shqyrtohet në Komisionin për Buxhet dhe Financa për implikimet e mundshme buxhetore.
2. Teksti i harmonizuar i Projektdeklaratës me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të MEF-it t'i paraqitet Kuvendit për miratim në seancën e ardhshme.

### **10. Shqyrtimi i mocionit të shtatë deputetëve të Kuvendit për shpalljen e 27 prillit – Ditë e të pagjeturve të Kosovës**

**Kryesuesi** e ftoi parashtresin e mocionit ta marrte fjalën.

Deputeti **Kamber Kamberi** në emër të shtatë deputetëve dhe të Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të të Zhdukurve e arsyetoi, para deputetëve të Kuvendit, propozimin që 27 prilli të shpallet ditë e të pagjeturve të Kosovës.

Opinione dhe sugjerime lidhur me shpalljen e 27 prillit ditë të të pagjeturve të Kosovës dhanë edhe këta deputetë: Alush Gasi, Ramë Buja, Gjylnaze Syla, Mahir Yagcilar, Gjergj Dedaj,

Sabri Hamiti, Emrush Xhemajli, Florë Brovina, Hydajet Hyseni, Ragip Zekolli, Xhevdet Neziraj, Sabit Rrahmani dhe Gjylshen Berisha, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Kamber Kamberi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68,  
Kundër----- 1,  
Abstenime----- 5.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

## **V E N D I M**

1. 27 Prilli shpallet Ditë e të Pagjeturve të Kosovës.
2. Vendimi është i përkohshëm dhe vlen derisa Kuvendi ta miratojë Ligjin që e rregullon këtë materie.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Kuvendit të Kosovës.

### **11. Njoftimi për vendimin e Kryesisë së Kuvendit për rishpalljen e konkursit për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit të tij kryesor**

**Kryesuesi** i informoi deputetët e Kuvendit për vendimin e Kryesisë të 5 shkurtit 2007 lidhur me procedimin e mëtejme për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit të tij kryesor.

Kryesia e Kuvendit kishte vendosur ta rishpallte konkursin për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit të tij kryesor, kurse nga UNMIK-u kishte kërkuar ta saktësonte procedurën e votimit që ka të bëjë me nenin 6 të Rregullores për Avokatin e Popullit në Kosovë.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 16:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**